

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-36/11**

**Prishtinë**

**15 Qershor 2011**

**Në procedurën e**

**M.K.**

***Parashtruesi i kërkesës/Ankuesi***

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/84/2010 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA35627, KPA35637, KPA35638, KPA35640, KPA35647, KPA35648, KPA35651 dhe KPA35652), datë 2 shtator 2010, në seancën gjyqësore të mbajtur më 15 Qershor 2011 mori këtë

**AKTGJYKIM**

**1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.K..**

- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës, KPCC/D/A/84/2010 i datës 2 shtator 2010 për sa i përket lëndëve të regjistruara nën numrat KPA35652, KPA35651, KPA35648, KPA35647, KPA35640, KPA35638, KPA35637 dhe KPA35627.
- 3- Ankuesi duhet të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 55 € (pesëdhjetë e pesë) Euro, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të aktgjyqimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **Zhvillimet procedurale dhe faktike:**

Me 11 prill 2007 M.K., në rolin e anëtarit të familjes, në emër të babait të tij të ndjerë ka paraqitur tetë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar të njihet si pronar i disa ngastrave të tokës të fituara nga trashëgimia, të jetë prapë në posedim të tyre dhe gjithashtu ka kërkuar kompensim për përdorimin ilegal të tyre. Ai ka shpjeguar se këto ngastra i kishin takuar babait të tij të ndjerë, V.K., i cili ishte lindur më 19 maj 1915 dhe se ato ishin zënë në mënyrë ilegale nga një person i panjohur. Ai ka pohuar se posedimi i pronës ishte humbur më 9 shtator 1999 si rezultat i konfliktit të armatosur.

Në mbështetje të kërkesës së tij ai i ka dorëzuar AKP-së dokumentet vijuese që kishin të bëjnë me statusin e tij civil dhe me statusin civil të prindërve të tij:

- Certifikatën e tij të lindjes të lëshuar më 14 janar 2000 nga Republika Federale e Jugosllavisë, Republika e Serbisë, Komuna e Rahovecit, që tregonte vendin e tij të lindjes si Zoqishtë, Rahovec, babanë e tij si “K.” K. dhe datën e lindjes së babait të tij si 10 maj 1915;
- Letërnjoftimin e tij të lëshuar më 2 nëntor 1999, që tregonte emrin e babait të tij si “K.”
- Certifikatën e vdekjes së V.K. të lëshuar më 11 shtator 2001, që theksonte se ai kishte lindur më 19 maj 1915 dhe kishte vdekur më 28 gusht 2001 në Kragujevc.

Në lidhje me ngastrat që ai pretendonte të kishte trashëguar nga V.K., dokumentet që ai ka dorëzuar në AKP janë me sa vijon:

Nr. i Ankesës dhe i lëndës së AKP-së	Të dhënat e ngastrës së pretenduar	Dokumentet e dorëzuar
GSK-KPA-A-36/11 (lënda KPA35652)	Ngastra Nr. 778 prej 1861 m <sup>2</sup> , që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, komerciale pa ndërtim (tokë/pyll), kullosë e klasës së 3-të	Fleta poseduese Nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekson se ngastra i përket për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-37/11 (lënda KPA35651)	Ngastra Nr. 777 prej 1086 m <sup>2</sup> , që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, komerciale pa ndërtim (tokë/pyll), kullotë e klasës së 3-të,	Fleta poseduese Nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekëson se ngastra i takon për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-38/11 (lënda KPA35648)	Ngastra Nr. 774 (që përbëhet nga dy pjesë: arë e klasës së 6-të prej 5228 m <sup>2</sup> dhe arë e klasës së 5-të prej 12510 m <sup>2</sup> ) që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, komerciale pa ndërtim (tokë/pyll)	Fleta poseduese Nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekson se ngastra i takon për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-39/11 (lënda KPA35647)	Ngastra Nr. 2898 prej 799 m <sup>2</sup> , që gjendet në Velika Hoca, Rahovec, Bar, komerciale pa ndërtim (tokë/pyll), vresht e klasës së 3 –të	Fleta poseduese Nr. 346, Rahovec, Velika Hoca, që thekson se parcela i takon për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-40/11 (lënda KPA35640)	Ngastra nr. 588 prej 3007 m <sup>2</sup> , që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, Debar/Potok, komerciale pa ndërtim (tokë/pyll), kullosë e klasës së 4-të	Fleta poseduese nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekson se parcela i takon për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-41/11 (lënda KPA35638)	Ngastra nr. 160 prej 1545 m <sup>2</sup> , që gjendet në Retimlje, Rahovec/, Lepse brdo – Vise reke, komerciale pa ndërtim	Fleta poseduese nr. 163, Rahovec, Retimlje, që thekson se ngastra i takon për 1/1 V.S.K.

	(tokë/pyll), arë e klasës së 4-të	
GSK-KPA-A-42/11 (lënda KPA35637)	Ngastra nr. 454 prej 1702 m <sup>2</sup> , që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, Prgan/Barusina, komerciale pa ndërtime (tokë/pyll), vresht e klasës së 3- të/kullosë	Fleta poseduese nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekson se parcela i takon për 1/1 V.S.K.
GSK-KPA-A-43/11 (lënda KPA35627)	Ngastra nr. 214/4 prej 162 m <sup>2</sup> , që gjendet në Zoqishtë, Rahovec, Prgan/Barusina, komerciale pa ndërtime (tokë/pyll), arë e klasës së 3-të	Fleta poseduese nr. 68, Rahovec, Zoqishtë, që thekson se ngastra i takon për 1/1 V.S.K.

Certifikata e vdekjes dhe fletët poseduese me numrat 68, 346 dhe 163 mund të verifikoheshin.

Më 29 nëntor 2007 (KPA35652, KPA35651, KPA35648, KPA35640, KPA35637, KPA35627), më 24 shtator 2008 (KPA35647) dhe më 16 shkurt 2010 (KPA35638), zyrtarët e AKP-së kishin shkuar në vendet ku pretendohet të ndodheshin ngastrat kontestuese dhe kishin vendosur shenja që tregonin se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të paraqisnin përgjigjet e tyre brenda muajit. Ata kishin vërejtur se prona e kërkuar, me përjashtim të pronës së kërkuar në KPA35627 (arë), nuk ishte e zënë (KPA35652, KPA35651, KPA35648, KPA35640: lëndinë apo kullosë; KPA35647: vresht e shkatërruar; KPA35638, KPA35637: tokë e papunuar). Mbajtësit të pronës së kërkuar në KPA35627 nuk është mundur t'i përcaktohet vendndodhja.

Më vonë në procedurë AKP kishte kontrolluar lajmërimin dhe ka mundur në bazë të “ortofotos dhe kordinatave të GPS”, të vërtetoj se lajmërimi ishte bërë në mënyrën e duhur.

Pasi që asnjë i paditur nuk kishte paraqitur përgjigje brenda afatit, të gjitha kërkesat ishin konsideruar si të pakontestueshme.

Pasi që certifikata e lindjes e parashtruesit të kërkesës kishte treguar se emri i babait të tij ishte “K.”, ndërsa fletët poseduese kishte paraqitur emrin e pronarit si “V.” dhe gjithashtu emri i të ndjerit në certifikatën e vdekjes ishte “V.”, Njësia e Informacionit e AKP-së kishte kontaktuar parashtruesin e

kërkesës më 10 mars 2008 dhe 24 shtator 2008, 18 shkurt 2009 dhe 8 maj 2009, duke kërkuar nga ai të dorëzonte deklarata të dëshmitarëve në lidhje me emrin e babait të tij. Secilën herë parashtruesi i kërkesës i kishte informuar ata se ai do të dorëzonte dokumentet e kërkuara brenda afatit 30 ditorë. Parashtruesi i kërkesës ishte kontaktuar përsëri më 24 dhjetor 2009 dhe me 26 prill 2010 dhe në që të dy këto raste atij i ishte dhënë një afat prej 30 ditësh për të dorëzuar një dokument të vërtetuar nga zyra e regjistrimit civil që shpjegonte mospërputhjen, përndryshe kërkesa e tij do të refuzohej. Parashtruesi kishte shpjeguar se ai do të ndërronte certifikatën e tij të lindjes dhe letërnjoftimin dhe se do t'i dorëzonte dokumentet e ndryshuar brenda afatit. Sido që të jetë, parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë dorëzimin e këtyre dokumenteve.

Më 2 shtator 2010, KKPK në një vendim grupor që kishte të bënte me 67 kërkesa përfshirë ato të parashtruesit të kërkesës, kishte refuzuar kërkesat për mungesë të provave për kapacitetin e parashtruesit të kërkesës për të parashtruar kërkesë në emër të bartësit të së drejtës së pronës (KPCC/D/A/84/2010).

Në dispozitiv të tijin KKPK konstaton:

*“(1) Në 59 (pesëdhjetenëntë) kërkesat të identifikuar në pjesët A dhe B të Shtojcës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesat të refuzohen. (2) Në 8 (tetë) kërkesat e identifikuar në pjesën C të Shtojcës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesat të refuzohen”.*

Më vonë KKPK kishte argumentuar:

*“[...] 18. Kërkesat në të cilat raporti i pretenduar familjar në mes të parashtruesit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore nuk mund të vërtetohet, nuk mund të konsiderohen kërkesa të plota në përputhje me Nenin 5.2 të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. [...]*

*21. Kërkesat me numrat 35627, 35637, 35638, 35640, 35647 dhe 35648 janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në emër të babait të tij, bartësit të së drejtës pronësore. Emri i bartësit të së drejtës pronësore është i regjistruar si V.K. në fletën poseduese dhe në certifikatën e vdekjes të dorëzuar me kërkesën, ndërsa në kartelën identifikuese dhe në certifikatën e lindjes të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës emri i babait të tij figuron si K.K.. Parashtruesi i kërkesës ishte kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive në pesë raste të ndara gjatë viteve 2008 dhe 2009 për të sqaruar ndryshimin e emrit dhe atij i ishte kërkuar të siguroi dhe të dorëzoi dokumente nga institucionet kompetente ku shpjegobeshin mospërputhjet. Parashtruesi i kërkesës kishte thënë se ai do të siguronte dokumentet e kërkuar dhe do të ndërmerrte hapa për të përmirësuar emrin e babait të tij në regjistrin zyrtar pasi që emri i babait të tij ishte V., jo K.. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë shtesë. Në mungesë të ndonjë prove që vërteton lidhjen familjare në mes të parashtruesit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore, kërkesa e parashtruesit të kërkesës mbetet për tu hedhur poshtë”.*

Kërkesat KPA35651 dhe KPA35652 nuk përmenden shprehimisht në këtë vendim. Vendimet individuale në lidhje me këto kërkesa i referohen Nenit 27 të vendimit grupor, ku, megjithatë, këto kërkesa nuk përmenden (por kërkesat me numra të ngjashëm të lëndëve: kërkesat 36551 dhe 36552).

Më 17 dhjetor 2010 KKPK ka lëshuar vendimet individuale të vërtetuara që kishin të bëjnë me secilën nga kërkesat të parashtruesit të kërkesës (Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendimin e KKPK më 23 shkurt 2011.

Më 4 mars 2011, M.K. (tash e tutje i njohur si: ankuesi) kishte paraqitur tetë ankesa në Gjykatën Supreme kundër vendimit KPCC/D/A/84/2010 mbi bazë të vërtetimit jo të plotë të fakteve dhe aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale. Ai thekson të drejtën e tij në posedim të pronave kontestuese dhe kërkon ri-posedim. Për aq kohë sa atij iu është mohuar kompensimi për pretendimin e tij për shfrytëzim ilegal, ankuesi nuk e kundërshton vendimin. Prapëseprapë, ai mbështet deklaratën e tij se ai është i biri i bartësit të së drejtës pronësore. Ai pretendon se kishte iniciuar procedurën për të korrigjuar librin amzë për të lindurit dhe se kjo procedurë, jo për faj tijin, kishte zgjatuar një kohë të gjatë. Në fund ai deklaron se ai ka arritur të përmirësoj të dhënat. Pasi që procedura e trashëgimisë nuk është kryer akoma, KKPK, për mendimin e tij, është dashur të vërtetoj se ai është trashëgimtar i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore dhe si i tillë ai ka të drejtë për ri-posedim të pronës së kërkuar. Për sa i takon kërkesave KPA35651 dhe KPA35652 ai për më tepër thekson se arsyetimi i vendimit është plotësisht i paqartë pasi që kërkesat e tij nuk përmenden në Nenin 27 të vendimit.

Për të mbështetur ankesën e tij, M.K. i kishte dorëzuar gjykatës një kopje të letërnjoftimit të tij të ri, që nuk jepte emrin e babait të tij dhe një certifikatë të dytë të lindjes. Kjo certifikatë ishte lëshuar më 28 tetor 2010 nga Republika e Serbisë, Komuna e Rahovecit, që paraqiste vendin e tij të lindjes si Zoqishtë, emrin e babait të tij si “V.” K. dhe datën e lindjes së babait të tij si 10 maj 1915.

### **Arsyetimi:**

Ankesa është refuzuar si e pabazë. Vendimi i KKPK-së (KPCC/D/A/84/2010) është vërtetuar.

Ankuesi nuk e ka provuar se është i biri i bartësit të drejtës pronësore dhe kështu ose si anëtar i familjes mund të dorëzoj një kërkesë në emër të babait të tij (të ndjerë) apo si trashëgimtar i babait të tij mund të paraqes një kërkesë në emër të tijin.

1. Neni 5.2 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 (UNMIK/DIR/2007/5) e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parashih me sa vijon: *“Në procedurën para Komisionit, në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga anëtar i familjes së ngushtë të atij person?”*.

Ankuesi këtu thekson se ai është i biri i pronarit të ndjerë të pronës. Prapëseparë ai nuk i ka dorëzuar KKPK-së por vetëm gjykatës në instancën apeluese certifikatën e lindjes që dëshmon se emri i babait të tij të jetë ai i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore: “V.” K..

- a. Neni 12.11 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 parashih *“Fakte e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë”*. Duket të jetë e diskutueshme nëse vetëm pretendimi i ankuesit se ai nuk ka qenë në gjendje të pajiset me certifikatë të lindjes më herët është fakt i mjaftueshëm për të përmbushur kushtet sipas ligjit. Por edhe nëse gjykata e lejon këtë provë të re dhe e merr atë parasysh, nuk është e mjaftueshme për të dëshmuar se ankuesi është i biri (dhe veç kësaj anëtar i familjes në fjalë në kuptim të UNMIK/DIR/2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore.
- b. Gjykata nuk ka nevojë të vendos, nëse certifikata e lindjes e lëshuar më 28 tetor 2010 ishte lëshuar nga organi kompetent. Edhe nëse ajo është lëshuar nga organi kompetent, ajo nuk paraqet ndonjë provë se pronari i ndjerë i pronës ishte i ati i parashtruesit të kërkesës.

Certifikata e vdekjes e bartësit së të drejtës pronësore paraqet emrin e tij si V.K. dhe datën e tij të lindjes si 19 maj 1915. Gjithashtu në kërkesën e tij ankuesi e ka dhënë datën e lindjes së babait të tij si 19 maj 1915. Certifikata e parë e lindjes e ankuesit, megjithatë, paraqet emrin e babait të tij si K.K. dhe datën e tij të lindjes si 10 maj 1915. Edhe pas korrigjimit, certifikata e lindjes e lëshuar më 28 tetor 2010 e jep datën e lindjes së babait të ankuesit si 10 maj 1915. Kjo datë e lindjes nuk është e njëjtë si dhe data e lindjes e pronarit të ndjerë të pronës, që është 19 maj 1915. Gjykata është e vetëdijshme se gabimet ndodhin dhe se data e lindjes mund të jetë kopjuar gabimisht nga regjistri. Por gabimi duket më tepër se i pamundshëm në

rastet kur data e lindjes është e shkruar dy herë pa ndryshim. Kështu që gjykata duhet të konstatoj që: ose certifikata e lindjes është provë se data e lindjes së babait të ankuesit nuk është data e lindjes e bartësit të së drejtës pronësore dhe se këta nuk janë i njëjti person ose gjykata mund të supozoj se certifikata e dytë e lindjes nuk paraqet të dhënat e futura në regjistër por është vetëm version i përmirësuar i certifikatës së parë të lindjes. Në të dyja rastet nuk ka prova që ankuesi të jetë i biri i djalit të bartësit të së drejtës pronësore.

2. Ky arsyetim gjithashtu vlen për aq kohë sa ankuesi dëshiron të kërkoj pronën në emrin e tij. Gjkata nuk ka dëshmi se ai është i biri i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore.
3. Pretendimi i ankuesit se në lëndët KPA35651 dhe KPA35652 arsyetimi ishte tërësisht i paqartë nuk e ndryshon pikëpamjen ligjore të diskutuar më lartë. Së pari, është e qartë nga argumentimi i vendimit të KKKP se arsyetimi në nenin 21 duhet të vlejë gjithashtu për këto dy lëndë të cilat janë tërësisht të ngjashme me të tjerat. Kjo është dashur të jetë edhe më e qartë për ankuesin i cili është kontaktuar dhe të cilit i ishin dhënë 6 herë afate për dorëzimin e provave, secilën herë në lidhje me të tërë tetë lëndët. Sa i përket referimit të vendimeve individuale ndaj nenit 27, është e qartë nga numrat e lëndëve të përmendura në këtë nen, se nuk vlen për lëndët në fjalë. Për më tepër, edhe nëse arsyetimi konsiderohet i paqartë, nuk ndikon vlerësimin ligjor se nuk ka prova që ankuesi të jetë i biri i bartësit të ndjerë të së drejtës në pronë. Dhe nuk ka mundësi që ankuesi do të kishte pasur shanse më të mira për të dorëzuar këtë provë nëse arsyetimi në këto dy lëndë shprehimisht do iu kishte referuar numrave të lëndëve të këtyre dy lëndëve.

### **Taksat gjyqësore:**

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 të Urdhëresës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që zhvillohet para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet edhe për procedurën para Kolegjit të Ankesave.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore, vlen ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Ankesave.



Prandaj, tarifat vijuese për shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës ( Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë, 27900 m<sup>2</sup> kullosë ose tokë e pakultivuar ose vreshtë e shkatërruar në Komunën e Rahovecit mund të vlerësohet me arsye prej € 2.501 deri në € 5000: € 25.

Këto taksa gjyqësore do të barten nga ankuesi i cili e humb rastin.

Sipas Neneve 46 dhe 45 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, nëse një person me banim ose vendbanim të përhershëm jashtë vendit është i obliguar të paguaj një tarifë, afati për pagesën nuk është më i shkurtër se 30 ditë dhe më i gjatë se 90 ditë nga data e dorëzimit të aktgjykimit. Si pasojë e mos-pagesës brenda afatit, do të urdhërohet përmbarimi i detyrueshëm përfshirë gjobën siç parashihet në Nenin 47 të të njëjtit ligj.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

**Nënshkruar nga:           Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit të Apelit, EULEX**

**Nënshkruar nga:           Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga:           Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga:           Urs Nufer, EULEX Registrar**